



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PROFESIONAL

Lënda: Gjeografi

Klasa: XIII

Struktura: 2+1+1

Tiranë, 2018



	Emër Mbiemër	Pozicioni	Data	Nënshkrimi
Koordinoi:	E.Mastori	Specialist i Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave dhe Standardeve	05.07.2018	
Pranoi:	D.Rapti	Drejtori i Drejtorisë së Kurrikulës, Standardeve dhe Kualifikimit	05.07.2018	

PËRMBAJTJA

1.	FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”	2
1.1.	HYRJE NË PROGRAMIN E GJEOGRAFISË.....	4
2.	KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT	6
2.1.	QËLLIMET E PROGRAMIT TË GJEOGRAFISË.....	8
2.2.	LIDHJA E KOMPETENCAVE KYÇE ME KOMPETENCAT E FUSHËS /LËNDËS	10
2.3.	LIDHJA E LËNDËS SË GJEOGRAFISË ME TEMAT NDËRKURRIKULARE	18
2.4.	LIDHJET E LËNDËS SË GJEOGRAFISË BRENDË FUSHËS DHE ME FUSHAT E TJERA TË TË NXËNIT	19
2.5.	KOMPETENCAT E LËNDËS DHE TEMATIKAT E SAJ.....	21
2.6.	KOHA MËSIMORE PËR TEMATIKË PËR SECILËN KLASË	24
3.	REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE PËR SHKALLËN E PESTË.....	25
4.	UDHËZIME METODOLOGJIKE	43
5.	UDHËZIME PËR VLERËSIMIN	46
6.	MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE.....	47

1. FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësi të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë; të përballet në mënyrë të suksesshme me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar, nxënësi:

- kultivon identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetëson vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohet në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillon përgjegjësi ndaj vetes, të tjerëve, shoqërisë dhe mjedisit;
- aftësohet për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillon shpirtin e sipërmarrjes;
- përdor teknologjitë e reja.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” i krijon nxënësit mundësitë të zhvillojë kompetencat e nevojshme për të përmbushur rolin e tij si anëtar i një shoqërie shumë kulturore dhe demokratike, në një botë gjithnjë e më të ndërvarur. Kompleksiteti i botës shoqërore sot po rritet për shkak se shoqëritë janë në një proces të vazhdueshëm ndryshimi dhe lidhjesh globale, shoqëruar me rritje të lartë të

lëvizshmërisë së popullsisë, shumëfishim të kontakteve midis kulturave të ndryshme, qarkullim të shpejtë të informacionit dhe rritje të globalizimit të ekonomisë. Lëndët që përbëjnë fushën “Shoqëria dhe mjedisi” zhvillojnë te nxënësi të menduarin kritik e krijues, pasurojnë kulturën e tyre dhe i përgatisin të luajnë një rol aktiv në një shoqëri demokratike. Ato nxitin zhvillimin intelektual të nxënësit duke i dhënë mekanizmat konceptualë dhe metodologjikë, të cilat nxënësi mund t’i përdorë në situata të ndryshme.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” integron njohuri, zhvillon shkathtësi, edukon qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve gjeografi, histori, qytetari, filozofi, sociologji, psikologji dhe ekonomi. Secila prej tyre e trajton botën dhe shoqërinë nga këndvështrime të ndryshme.

Përmes kësaj fushe nxënësi zhvillon:

- konceptin e tij hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë e vendeve dhe rajoneve në botë. Nxënësi aftësohet të vlerësojë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin, për të ndërmarrë veprime që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm;
- bazat e qytetarisë duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to;
- konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe zbaton këtë kuptim në analizën e pasojave të veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri, në të kaluarën dhe sot.

Përvojat mësimore të kësaj fushe të nxëni në këtë shkallë i shërbejnë përmbushjes së kompetencave kyçe, me fokus të veçantë kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar e kulturor.

1.1. HYRJE NË PROGRAMIN E GJEOGRAFISË

Gjeografia është shkenca e vendit, hapësirës dhe mjedisit. Ajo është një mënyrë e strukturuar e zbulimit, analizës dhe shpjegimit të dukurive dhe karakteristikave të Tokës, banorëve të saj dhe marrëdhënieve të ndërsjella midis tyre. Mësimi i gjeografisë i ofron nxënësit mundësi të kuptojë veçoritë natyrore dhe shoqërore të mjedisit gjeografik, diversitetin e vendeve dhe rajoneve në botë, të njerëzve dhe kulturave, ndërvarësinë dhe ndërveprimin si dhe marrëdhëniet e njeriut me mjedisin në nivel lokal, rajonal dhe botëror.

Ndryshimet e shumta që po përjeton shoqëria e sotme kanë modifikuar marrëdhënien tonë me mjedisin. Shumëllojshmëria e informacionit dhe shpërndarja e tij marramendëse, shtimi i shkëmbimeve të llojeve të ndryshme, globalizimi i ekonomisë dhe lëvizjet e popullsisë, i bëjnë largësitë më të vogla dhe ndikojnë në mënyrën sipas së cilës ne shohim botën. Në këtë kuptim, lënda e gjeografisë ka një rëndësi të veçantë për përgatitjen e nxënësit për të jetuar dhe për t'u integruar në shoqëri, për kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar dhe edukimin për të jetuar së bashku, për një zhvillim sa më të qëndrueshëm.

Programi i gjeografisë ndihmon në zhvillimin e kompetencave kyçe në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës. Zhvillimi i kompetencave është pikënisja dhe parimi bazë organizativ i këtij programi. Përmbajtja lëndore konceptohet si mjet për realizimin e tyre nëpërmjet zhvillimit të situatave të të nxënit.

Nxënësi përvetëson mjetet dhe “gjuhën” gjeografike teksa hulumton marrëdhënien e njeriut me vendet dhe mjedisin, njëkohësisht zbulon rolin që duhet të përmbushë për zhvillimin e qëndrueshëm. Ai mëson t'u përgjigjet problemeve gjeografike duke përdorur prezantimet hapësinore që ka përdorur më parë, të cilat tashmë i modifikon dhe i zhvillon.

Vëzhgimet dhe puna në terren, puna me hartën, interpretimi i shpërndarjes hapësinore të veçorive natyrore dhe shoqërore në Tokë dhe ndërvarësive midis tyre, zhvillojnë shkathtësitë themelore gjeografike në këtë nivel shkollimi.

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të

lartë dhe plani mësimor i arsimit të mesëm të lartë.

Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit** për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe kompetencave të lëndës së gjeografisë, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri.
- **Mësuesit** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kritereve të vlerësimit.
- **Hartuesit të teksteve mësimore** dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Zbatimi i programit bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

Programi i gjeografisë për shkallën e pestë të kurrikulës është konceptuar dhe hartuar në funksion të qasjes kurrikulare me bazë kompetencat.

- Ky program krijon kushtet për zhvillimin e *kompetencave kyçe* dhe *kompetencave të lëndës* që lidhen me to. Kompetencat e lëndës lidhen me kompetencat kyçe nëpërmjet rezultateve të të nxënit të secilës prej tyre. Lidhja mes rezultateve të të nxënit të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe siguron zhvillimin e ndërsjellë të tyre dhe mundëson integrimin lëndor.
- Kompetencat zhvillohen përmes *tematikave të përbashkëta të fushës* dhe në program zërthehen në njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera. Tematikat e përbashkëta të fushës janë elemente të rëndësishme të programit të gjeografisë sipas të cilave strukturohet përmbajtja lëndore dhe integrimi konceptual brenda fushës, në funksion të zhvillimit të kompetencave. Programi i gjeografisë për shkallën V të kurrikulës është i strukturuar rreth dy tematikave të mëdha: “Proceset natyrore dhe shoqërore” dhe “Ndërvarësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve”. Për secilën prej tyre përcaktohen rezultatet e pritshme të shprehur në terma njohurishë, shkathtësishë dhe qëndrimesh. Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe nuk përmbushen jashtë tematikave. Ato janë marrë në konsideratë në të gjithë procesin e hartimit të rezultateve të të nxënit për tematikë duke qenë pjesë integrale e tyre.
- Strukturimi dhe organizimi i programit për *shkallë kurrikule* synon ta bëjë këtë program më fleksibël, duke i ndihmuar dhe u lënë dorë më të lirë mësuesve për ta zbatuar atë në mënyrë krijuese, si dhe të respektojnë ritmet individuale të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave të detajuara në çdo shkallë të kurrikulës.
- Strukturimi i programit mbi rezultatet e të nxënit për kompetencë ndihmon në planifikimin dhe zhvillimin e *situatave të të nxënit* dhe lehtëson vlerësimin e nxënësit për kompetencat kyçe. Situatat e të nxënit janë situata që lidhen me kontekstin e të

nxënit. Ato mund të jenë situata në mjedise të mbyllura ose të hapura të nxëni, brenda shkollës ose jashtë saj. Roli i mësuesit në mësimdhënien përmes situatave është ai i udhëheqësit e i lehtësuesit gjatë nxënies aktive të nxënësit.


- Konceptimi i kurrikulës me bazë kompetencat krijon mundësitë dhe kërkon zbatimin e integruar të saj. Programi i gjeografisë krijon mundësi *integrimi brenda fushës dhe me fushat e tjera*, si shkencat e natyrës, matematikën, gjuhët dhe komunikimin, etj. Në shumë aspekte, programi i gjeografisë përqendrohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare. Ato shërbejnë si çështje kyçe për zhvillimin e kompetencave, integrojnë fushat e të nxënit dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme.
- Programi sugjeron *metoda, teknika, strategji të mësimdhënies e të nxënies* që nxisin interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënit të tyre.
- *Vlerësimi* si pjesë integrale e procesit të të nxënit mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësit. Vlerësimi merr shumë forma, të cilat i parashikon dhe mundëson struktura dhe konceptimi i programit.

2.1. QËLLIMET E PROGRAMIT TË GJEOGRAFISË

Programi i gjeografisë për shkallën e 5-të synon që nxënësi:

- të zhvillojë dijet për dukuritë gjeografike, fizike dhe humane, në shkallë të ndryshme, mbi bazën e ballafaqimit të vazhdueshëm të të menduarit kritik e krijues;
- të zhvillojë kuptimin për ligjet e përgjithshme të gjeosistemit dhe të veprojë në përputhje me to për zgjidhjen e problemeve gjeografike të jetës së përditshme;
- të zhvillojë interesin dhe respektin për vendin ku jeton, për vende të tjera, për njerëzit dhe mënyrën si ata ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe mjedisin ku jetojnë;
- të kuptojë mundësitë dhe sfidat e ndërvarësisë globale;
- të zhvillojë shkathtësitë për të qenë përdorues kritik dhe krijues i metodave të kërkimit gjeografik;
- të edukohet si qytetar i informuar, i përgjegjshëm dhe aktiv, i cili mund të kontribuojë për zhvillimin e një bote të qëndrueshme.

Diagrama 1: Korniza konceptuale e programit



2.2. LIDHJA E KOMPETENCAVE KYÇE ME KOMPETENCAT E FUSHËS /LËNDËS

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësi gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënit. Kompetenca përcaktohet si ndërthurje e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet të fitojë dhe përdorë gjatë procesit të nxënies.

Kompetenca qytetare

Programi i gjeografisë, si pjesë e fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencës qytetare. Përmes kërkimit gjeografik për çështje të tilla, si ndërvarësia, shfrytëzimi i burimeve natyrore, qëndrueshmëria mjedisore në nivel lokal e global etj., nxënësi nxitet të mendojë në mënyrë kritike dhe të marrë vendime që ndihmojnë në zhvillimin e tij si individ.

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Programi i gjeografisë krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi përdor materiale të printuara, vizuale dhe digjitale për të eksploruar dukuritë, proceset gjeografike, vendet dhe rajonet. Ai mëson si të vlerësojë këto burime dhe të kuptojë se si gjuha mund të përdoret për të manipuluar të nxënit. Përmes diskutimeve, debateve apo prezantimeve të punimeve e detyrave që ndërmerr, nxënësi zhvillon shkathtësi të të shprehurit, zhvillon dhe përdor në mënyrë progresive fjalorin gjeografik për të komunikuar idetë në mjedise të ndryshme.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe analizon argumentet. Ai zhvillon shkathhtësi për marrjen e vendimeve dhe strategji që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues e të zhvillojë imagjinatën përmes veprimtarive në klasë dhe vëzhgimeve në terren.

Programi i gjeografisë mundëson zbatimin e shkathhtësive matematikore për kryerjen e analizave statistikore, ndërtimin e grafikëve, tabelave, llogaritjen dhe interpretimin e të dhënave. Në punën me hartën, nxënësit punojnë me koncepte numerike, të tilla si: shkalla, largësia, koordinatat, projeksionet.

Kompetenca e të mësuarit

Në procesin e kërkimit gjeografik nxënësi zhvillon kompetencën e të nxënësit. Programi mundëson që nxënësi të shfrytëzojë në mënyrë efektive përvojat paraprake për zgjidhjen e situatave të ndryshme dhe realizimin e veprimtarive; të parashtojë pyetje për çështje të ndryshme dhe të organizojë mendimet për të gjetur përgjigje për një situatë/problem të caktuar gjeografik. Nxënësi aftësohet të paraqesë/skicojë idetë e tij për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarive duke e argumentuar para të tjerëve. Për këtë, shfrytëzon në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni, vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësit vlerësojnë rëndësinë e punës individuale dhe në grup për zhvillimin e komunitetit nëpërmjet shembujve konkretë nga jeta e përditshme, zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin gjeografik, analizojnë elementë të situatës, kompleksitetin e saj, vlerësojnë rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri.

Kompetenca personale

Programi i gjeografisë nxit të nxënit bazuar në kërkim duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësit kuptojnë rolin e tyre në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive, shkathtësive dhe në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

Kompetenca digjitale

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur heton, krijon, komunikon idetë dhe informacionin për proceset e dukuritë gjeografike, për vendin e tij, vendet e tjera në botë dhe marrëdhënien e njeriut me mjedisin.

Diagrama 2: Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjeografisë në shkallën e pestë

SHKALLA V

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)

Nxënësi:

- shprehet përmes një forme të komunikimit, për një temë të caktuar në një material gjeografik (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material (prezantim);
- përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës amtare në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj. ;
- prezanton një projekt, të hartuar individualisht dhe në grup, për një temë të caktuar gjeografike duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.

Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)

Nxënësi:

- prezanton, në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse;
- krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme

shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative;

- harton një detyrë me tekst, apo krijon një situatë logjike nga jeta e përditshme, e cila përmban një mesazh që kërkon zgjidhje duke u bazuar në njohuritë paraprake, prezanton mënyrën/procedurën e zgjidhjes së problemit para të tjerëve;
- krijon një situatë për marrjen e një vendimi për jetën e vet ose zgjidhjen e një problemi me interes shoqëror, lidh vendimin me pasojat në mënyrë të përgjegjshme, e prezanton gjatë një debati me moshatarë në një kohëzgjatje të caktuar, duke u bazuar në këtë përvojë, merr vendime dhe iniciativa të dobishme për vete, për shkollën dhe më gjerë.

Kompetenca e të mësuarit (Nxënësi mëson për të nxënë)

Nxënësi:

- shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre ose veprimtarie në lëndën e gjeografisë, diskuton dhe ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave paraprake në arritjen e dijeve të reja;
- parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejshëm të të nxënit për temën apo problemin e caktuar;
- zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme;
- në bazë të një planifikimi të dhënë dhe në bazë të rezultatit të fituar vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në situata dhe kontekste të tjera gjatë të nxënit;
- përgatit me sukses një përmbledhje të dosjes personale (portofolit), me jo më pak se 900 fjalë, me qëllim të vetëvlerësimit të përparimit të vet në një fushë mësimore të caktuar, veçon në fund të përmbledhjes disa çështje që vërtetojnë përparimin e vet dhe

disa nevoja të domosdoshme për përmirësimin e avancimit të mëtejshëm;

- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë ose për të zgjidhur një problem që kërkohet prej tij, vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare (p.sh., burime të informacionit në libër, revistë, enciklopedi, internet, hartë, grafik, skicë etj).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)

Nxënësi:

- përgatit, prezanton, drejton dhe merr pjesë në një fushatë të informimit të qytetarëve për një temë të caktuar, duke u mbështetur në ide të reja, bazuar në rezultate të pritshme të përcaktuara qartë (p.sh., fushatë informimi për mbrojtjen e mjedisit etj.);
- hulumton dhe analizon forma të ndryshme të sipërmarrjes për mundësi të orientimit për karrierën, si dhe për të kontribuar në të mirë të komunitetit;
- demonstroi shprehje organizative në punët individuale dhe në ekip përmes situatave reale në detyrat e veçanta mësimore apo në veprimtari për jetë, për punë dhe për mjedis duke menaxhuar potencialin individual dhe atë të grupit si dhe kohën, rreziqet dhe buxhetin në dispozicion;
- harton një projekt me faza të menaxhuara mirë (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme;
- analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në shkollë, në komunitet apo më gjerë), pasojat e ndotjes, propozon alternativa për mbikëqyrje dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme dhe iniciacion zgjidhje konkrete.

Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)

Nxënësi:

- analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke i evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal, në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale.

Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)

Nxënësi:

- demonstroi shembuj të pjesëmarrjes demokratike dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike në nivele të ndryshme (p.sh.: në familje, në shkollë, në komunitet, në nivel lokal dhe nivel shtetëror) duke treguar tolerancë dhe respekt për pyetjet dhe komentet e të tjerëve;
- demonstroi shembuj konkretë të mbrojtjes së mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu në veprimtari të jetës së përditshme në shtëpi, në klasë, në shkollë dhe në komunitet, propozon alternativa se si të gjithë qytetarët mund të ndihmojnë në mënyra të ndryshme për këtë proces;
- diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të shprehurit, paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.

Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)

Nxënësi:

- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh të ndryshme;
- përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet vizualizimeve të filmuara apo të animuara.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës, mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh përmbajtjen mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave të gjeografisë në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do të arrijë rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë në lëndën e gjeografisë.

2.3. LIDHJA E LËNDËS SË GJEOGRAFISË ME TEMAT NDËRKURRIKULARE

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i gjeografisë përqëndrohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, kryesisht në temat:

- ❖ Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- ❖ Zhvillimi i qëndrueshëm.
- ❖ Mjedisi.
- ❖ Ndërvarësia.
- ❖ Bashkëjetesa paqësore.

Programi ndihmon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvarësinë dhe bashkëjetesën paqësore.

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë me mjedisin nga perspektiva e menaxhimit të përgjegjshëm, nxënësi mëson të vendosë lidhje midis nevojave dhe përdorimit racional të burimeve. Ai ndërgjegjësohet për aspektet shoqërore të konsumit, për implikimet e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvarësinë e mjedisit nga veprimtaria njerëzore. Në këtë mënyrë, programi ndihmon për edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mjedisin. Përmes studimit të vendeve dhe rajoneve të ndryshme, transferimit të të nxënit në vendin e tij, nxënësi ndërgjegjësohet për rolin e tij si qytetar. Kjo e ndihmon atë të jetë mendjehapur dhe të respektojë diversitetin. Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvarësinë e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes.

Zhvillimi i karrierës

Një ndër synimet kryesore të programit të gjeografisë në shkollën e pestë dhe më tej, është të zhvillojë orientimin për karrierat që lidhen me fushën e studimit të gjeografisë dhe dimensione të saj, të tilla si ai i gjeografit, meteorologut, sizmologut etj.

LIDHJET E LËNDËS SË GJEORAFISË BRENDË FUSHËS DHE ME FUSHAT E TJERA TË TË NXËNIT

Konceptimi i programit të gjeografisë në fushën "Shoqëria dhe mjedisi" është mbështetur në parime të mirëfillta të integritimit. Për t'i siguruar nxënësit zhvillimin e kompetencave, është e rëndësishme lidhja e lëndëve brenda fushës, të cilat ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën.

Lidhja e gjeografisë me historinë i shërben nxënësit të kuptojë më mirë ndryshimet që kanë pësuar kulturat e ndryshme dhe ndikimin e tyre në zhvillimet e vendeve dhe rajoneve, si dhe sfidat e ndërvarësisë globale. Nxënësi hulumton mbi historinë e mendimit gjeografik për të kuptuar evolucionin e ideve dhe teorive.

Lidhja e gjeografisë me qytetarinë. Programi i gjeografisë ndihmon në zhvillimin e dimensioneve të qytetarisë. Ai e sheh botën si bashkësi globale dhe të ndërvarur. Nxënësi identifikon probleme, sugjeron zgjidhje dhe reflekton për marrjen e vendimeve. Gjeografia u jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret qytetaria dhe ndihmon në debate për çështje dhe ngjarje të rëndësishme.

Gjeografia është ngushtësisht e lidhur me fushat e tjera të të nxënit.

Si të gjitha lëndët e tjera, gjeografia krijon mundësi të zbatimit të kompetencave që zhvillon fusha "Gjuhët dhe komunikimi". Gjuha është themelore për të nxënin e nxënësve në lëndën e gjeografisë. Nxënësi përzgjedh strategjitë e përshtatshme gjuhësore për të eksploruar, prezantuar dhe komunikuar të kuptuarin e dukurive gjeografike. Ai përdor gjuhën letrare për të shprehur pozicionin e tij qartë dhe në mënyrë koherente. Por njëkohësisht dhe gjeografia ndihmon në zgjerimin dhe përpunimin e fjalorit të nxënësit, duke e nxitur atë të parashtrojë qartë dhe saktësisht idetë e tij, me gojë ose me shkrim. Punët praktike, projektet dhe detyrat që nxënësi realizon, i mundësojnë zhvillimin e kompetencës së komunikimit gjuhësor dhe pasurimin e fjalorit terminologjik. Termat e ndryshme, të përdorura në këtë lëndë, janë specifike dhe ndihmojnë nxënësin për zhvillimin e kompetencës së komunikimit përmes përdorimit të gjuhës dhe terminologjisë gjeografike.

Gjithashtu, e rëndësishme është *lidhja e gjeografisë me shkencat e natyrës*. Gjeografia është një urë lidhëse ndërmjet shkencave natyrore dhe shoqërore. Shumë prej njohurive të fushës së shkencave natyrore janë themelore për kuptimin dhe interpretimin e dukurive gjeografike në Tokë; p.sh., zbatimi i ligjit të tërheqjes së gjithësisë për të shpjeguar tërheqjen e Tokës, Hënës, qëndrimin e planeteve në orbitën rreth Diellit; njohuritë mbi natyrën e valëve gjatësore dhe procesin e përhapjes së tyre në mjedis për të interpretuar valët detare; vetitë dhe përbërja e lëndës për të kuptuar mineralet; zbatimi i periodës së gjysmëzbërthimit dhe metodës së atomeve të shënuara të dukurisë së radioaktivitetit për të përcaktuar moshën absolute të shkëmbinjve etj., janë shembuj të zbatimit të ligjësisë dhe teorive shkencore në dukuritë gjeografike.

Lidhja e gjeografisë me matematikën. Nxënësi zhvillon njohuritë matematikore përmes përdorimit të informacioneve sasiore dhe cilësore, leximit apo ndërtimit të hartave, grafikëve dhe tabelave statistikore. P.sh., nxënësi llogarit mesataren ditore, mujore apo vjetore të temperaturave të ajrit; llogarit kohën lokale e zonale mbi bazën e veprimeve me thyesa; ndërton grafikë të shpërndarjes së reshjeve, temperaturës dhe i interpreton ato. Nxënësi ndërton diagrame që paraqesin strukturën e popullsisë së një vendi apo rajoni, të ekonomisë dhe sektorëve të saj etj.

Lidhja e gjeografisë me TIK-un. Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) mbështet të nxënit në lëndën e gjeografisë përmes realizimit të detyrave të ndryshme, projekteve, kërkimit, përpunimit dhe prezantimit të informacionit. Nxënësi mëson të përzgjedhë informacionin dhe të mbajë qëndrim kritik ndaj tij, të dallojë faktin nga opinioni. Nxënësi mund të përdorë word-processor në shkrimin e materialeve, zbaton hedhjen e të dhënave në tabelë për ndërtimin e grafikëve, përdor power point për prezantimin e një detyre, kërkon në internet harta dhe përcakton vendndodhjen e objekteve të ndryshme.

2.4. KOMPETENCAT E LËNDËS DHE TEMATIKAT E SAJ

Përmes programit të gjeografisë, në shkallën e pestë të kurrikulës, mundësohet zhvillimi i kompetencave të lëndës, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë gjithë jetës. Programi i gjeografisë, nëpërmjet të gjithë tematikave të tij dhe situatave të të nxënësve, zhvillon dhe ndërton kompetencat e lëndës, të cilat janë pjesë e kërkimit gjeografik.

Tematikat mbi të cilat është organizuar përmbajtja e programit kanë të bëjnë me njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, nëpërmjet të cilave do të realizohen këto kompetenca. Shkathtësitë dhe qëndrimet, ashtu sikurse njohuritë, janë objekt i të nxënësve të rregullt dhe progresiv. Shkathtësitë dhe aftësitë u lejojnë nxënësve, që nën udhëheqjen e mësuesit apo në mënyrë të pavarur, të ndërtojnë, përvetësojnë, organizojnë njohuritë dhe të reflektojnë mbi to.

Disa nga shkathtësitë janë specifike për gjeografinë (p.sh., nxënësit lokalizojnë, orientohen në hapësirë, lexojnë dhe përdorin gjuhën hartografike), ndërsa të tjerat kanë të bëjnë me shkathtësi që gjeografia ndan me fushat e tjera dhe që janë të domosdoshme për të gjithë procesin e të nxënësve (p.sh., komunikojnë me shkrim dhe me gojë, përshkruajnë, identifikojnë etj.). Çdo situatë të nxënësve shoqërohet domosdoshmërisht me shumë prej këtyre shkathtësive.

Në shkallën e pestë, programi i gjeografisë zhvillon kompetencat e mëposhtme lëndore, të cilat lidhen me kërkimin gjeografik:

- ❖ *Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.*
- ❖ *Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit.*
- ❖ *Marrja e vendimeve mbi bazën e informacionit të mbledhur.*

Tabela: Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës në shkallën e pestë

SHKALLA V

Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi:

- përcakton një çështje gjeografike për kërkim/hetim;
- formulon pyetje ose jep shpjegim, zgjidhje ose opinion duke përcaktuar disa aspekte thelbësore të çështjes;
- përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike që ndodhin në sistemet natyrore të Tokës dhe dukurive gjeografike që ndodhin në vende dhe rajone të ndryshme.

Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi:

- përdor burime informacioni që mund të ndryshojnë besueshmërinë e tyre;
- zgjedh burimet më të përshtatshme nga tërësia e burimeve parësore dhe dytësore në dispozicion;
- përcakton metodat, strategjitë ose teknikat e përshtatshme;
- komunikon (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht) shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

Marrja e vendimeve

Nxënësi:

- jep shpjegime në lidhje me çështjen gjeografike të marrë në shqyrtim;
- identifikon pasojat që mund të shoqërojnë zgjidhjen e çështjes;
- identifikon rrugë të ndryshme të veprimit;
- përdor pyetje për të reflektuar në çdo fazë të kërkimit :“Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet?”.

2.5. KOHA MËSIMORE PËR TEMATIKË PËR SECILËN KLASË

Programi i gjeografisë për klasën XIII zhvillohet në 34 orë mësimore gjithsej. Në program specifikohen orët e sugjeruara për secilën nëntematikë. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat dhe projektet, vëzhgimet në natyrë, testimet e ndryshme. Sasia e orëve mësimore për secilën nëntematikë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara.

SHKALLA V

Klasa XIII

(1 orë mësimore/javë x 34 javë)

Tematika	Nëntematikat	Orë të sugjeruara
Ndërvarësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve. (34 orë)	Hapësira në trajtimin gjeografik rajonal.	2
	Evropa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare.	5
	Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë.	5
	Popullsia dhe ekonomia e Republikës së Shqipërisë.	5
	Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë.	17

3. REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE PËR SHKALLËN E PESTË

Në programin e gjeografisë për klasën XIII janë paraqitur rezultatet e të nxënit për tematikën “Ndërvarësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve”, në funksion të zhvillimit të kompetencave.

Rezultatet e të nxënit shprehen në terma njohurish, aftësish dhe qëndrimesh. Kombinimi dhe ndarja e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në situata të nxëni, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë mësuesit dhe autorët e teksteve).

KLASA XIII

TEMATIKA: NDËRVARËSIA MIDIS NJERËZVE, RAJONEVE DHE MJEDISEVE

Përshkrimi i tematikës:

Tematika “Ndërvarësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve” në klasën XIII zhvillon te nxënësit njohuri, shkathtësi dhe qëndrime të cilat kanë të bëjnë me trajtimin gjeografik rajonal, duke pasur në fokus kryesor hapësirën e vendit tonë, Shqipërinë. Në këtë kuadër, formimi gjeografik i nxënësit fokusohet në tre drejtime: në trajtimin teorik të konceptit të rajonit dhe tipeve të rajoneve; në trajtimin e hierarkisë dhe lidhjeve rajonale midis Evropës, rajonit, Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare; si dhe në trajtimin e detajuar të katër rajoneve gjeografike të Republikës së Shqipërisë, dallimeve dhe mundësive në zhvillimet e ndryshme rajonale të vendit.

Programi synon që nxënësit të aftësohen të zbulojnë dhe argumentojnë lidhjet shkak-pasojë të dukurive dhe proceseve që ndodhin në rajone të ndryshme gjeografike, të zhvillojnë aftësi të kërkimit gjeografik përmes hulumtimit të tipareve dhe veçorive të rajoneve të veçanta të vendit tonë, si dhe të bëjnë gjykime e të zhvillojnë qëndrime në lidhje me perspektivat e zhvillimit të qëndrueshëm rajonal.

Përmes detyrave, punëve praktike, projekteve kurrikulare e strategjive të tjera ndërvepruese, përdorimit të teknologjisë së informacionit, nxënësit aftësohen në kërkimin gjeografik dhe zhvillojnë të menduarin kritik e krijues, zhvillojnë shkathtësi të komunikimit dhe të punës në grup. Përmes përdorimit të burimeve të ndryshme, si: harta, fotografi, statistika, diagrame, ilustrime fotosh dhe video etj., nxënësit zbulojnë dhe përvetësojnë informacione dhe koncepte gjeografike si për Shqipërinë në përgjithësi, ashtu edhe për rajonet e saj gjeografike në veçanti.

REZULTATET E TË NXËNIT

NËNTEMATIKA: HAPËSIRA NË TRAJTIMIN GJEOGRAFIK RAJONAL

Njohuritë	Shkathtësitë	Qëndrimet / vlerat
<ul style="list-style-type: none"> ❖ Rëndësia e trajtimit rajonal të hapësirës gjeografike. ❖ Rajoni në kuptimin e tij të përgjithshëm. Kriteret e rajonizimit dhe tipet e rajoneve. ❖ Kuptimi i sotëm evropian mbi rajonin në kuadër të BE nën moton: “Bashkëjetesë në diversitet”. Kalimi nga Evropa e shteteve drejt asaj të rajoneve. ❖ Zhvillimi i konceptit shqiptar mbi rajonin. Kriteret dhe problematikat e rajonizimit gjeografik në Shqipëri. 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlerëson</u> dhe <u>argumenton</u> rëndësinë e trajtimit rajonal të territorit (hapësirës); ➤ <u>identifikon</u> kriteret bazë të rajonizimit gjeografik dhe tipet e ndryshëm të rajoneve; ➤ <u>shpjegon</u> kuptimin e sotëm evropian mbi rajonin nën frymën e respektimit të diversitetit dhe ndërveprimit rajonal; ➤ <u>sjell shembuj</u> të rritjes së ndërvarësisë rajonale përmes proceseve ekonomike, politike, mjedisore dhe shkëmbimeve kulturore në Evropë; ➤ <u>interpretin</u> zhvillimin e konceptit shqiptar për rajonin; ➤ <u>identifikon</u> kriteret e rajonizimit gjeografik në Shqipëri; 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>demonstron</u>, përmes studimit të gjeografisë, aftësitë qytetare, të cilat ndihmojnë në rritjen personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri; ➤ <u>vlerëson</u> dhe <u>shpreh ndjeshmëri</u> ndaj menaxhimit të qëndrueshëm të rajoneve; ➤ <u>vlerëson</u> dhe <u>respekton</u> pikëpamjet e të tjerëve; ➤ <u>tregon</u> integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit; ➤ <u>paraqet</u> dhe <u>komunikon</u> lirshëm

<p>❖ Rëndësia e trajtimit rajonal të vendit për integrimin e tij në BE si një nga kriteret e këtij integrimi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlërëson</u> problematikat që shoqërojnë rajonizimin gjeografik të vendit tonë; ➤ <u>argumenton</u> rëndësinë që ka rajonizimi dhe trajtimi i zhvillimeve rajonale të vendit si një nga kriteret për integrimin e tij në BE; ➤ <u>sjell shembuj</u> të standardeve që kanë përmbushur vende të tjera anëtare apo candidate të BE-së me zhvillimet e tyre rajonale. 	<p>mendimet e tij;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>demonstron</u> objektivitet dhe paanësi; ➤ <u>demonstron</u> pavarësi dhe besim në vetvete; ➤ <u>respekton</u> përpjekjet personale dhe ato në grup.
---	---	--

NËNTEMATIKA: EVROPA, RAJONI, SHQIPËRIA DHE TREVAT E TJERA SHQIPTARE

<p>❖ Evropa: karakteristika të përgjithshme dhe veçori rajonale.</p>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>argumenton</u> rëndësinë e pozitës gjeografike të Evropës dhe rolin e saj për zhvillimin dhe marrëdhëniet me rajonet e tjerë të botës; ➤ <u>përshkruan</u> tiparet më të përgjithshme natyrore, demografike, ekonomike dhe kulturore të Evropës; ➤ <u>vlërëson</u> ndërvarësinë midis rajoneve të Evropës dhe sjell shembuj të ndërvarësisë 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>zhvillon</u> ndjenjën e identitetit kombëtar dhe të respektit e mirëkuptimit për vendet dhe e popujt fqinj e më gjerë; ➤ <u>vlërëson</u> trashëgiminë natyrore dhe kulturore; ➤ <u>vlërëson</u> dhe <u>respekton</u> politikat globale dhe rajonale për zhvillimin e qëndrueshëm;
--	---	---

❖ Evropa Juglindore dhe vendi i hapësirës shqiptare në të.

❖ Hapësira mesdhetare dhe roli i saj në zhvillimin e hapësirave shqiptare.

❖ Trevat shqiptare:

🌍 përbërja dhe ndryshimet në hartën politike;

🌍 tipare të zhvillimit rajonal.

dhe bashkëveprimet rajonal;

➤ vlërëson pozitën gjeostrategjike të hapësirës shqiptare në Evropën Juglindore dhe rolin e saj për zhvillimin dhe bashkëpunimin ndërrajonal e më gjerë;

➤ vlërëson vendin e rëndësishëm që zë hapësira shqiptare si pjesë e Mesdheut, me tiparet e veçanta që e shoqërojnë natyrën, popullimin dhe ekonominë;

➤ analizon pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Evropë dhe më gjerë;

➤ vlërëson rolin e kësaj pozite në veçoritë natyrore gjeografike, në popullimin e trevave dhe zhvillimin ekonomik, dhe pasojat e kësaj pozite në copëtimin e trevave shqiptare;

➤ analizon ndryshimet që ka pësuar në kohë dhe në hapësirë harta politike e trevave shqiptare;

➤ argumenton rëndësinë e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis vendeve e popujve fqinjë e më gjerë, në kuadër të perspektivës

➤ vlërëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve;

➤ tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;

➤ paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij;

➤ demonstron pavarësi dhe objektivitet në kryerjen e detyrave;

➤ respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.

❖ Republika e Kosovës:

🗺 tiparet gjeografike natyrore;

🗺 tipare të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik.

të të gjitha trevave shqiptare dhe të shteteve ku ato ndodhen në familjen e madhe evropiane;

➤ analizon tiparet e përgjithshme gjeografike natyrore të Republikës së Kosovës:

✓ pozitën gjeografike,

✓ kushtet dhe pasuritë natyrore,

✓ trashëgiminë natyrore;

➤ analizon tiparet e përgjithshme të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik të Republikës së Kosovës:

✓ strukturën dhe ecurinë e numrit të popullsisë (faktorët),

✓ shpërndarjen gjeografike të popullsisë,

✓ zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë dhe shkallën e zhvillimit;

➤ evidenton, me ndihmën e hartës, diferencimin rajonal të Republikës së Kosovës;

➤ vlerëson akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Kosovës me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për

❖ Trevat e tjera shqiptare në rajon (në Maqedoninë perëndimore, në Mal të Zi, në Serbi, në Greqi):

🌍 veçoritë natyrore;

🌍 tipare të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik;

🌍 tiparet e diferencimit në zhvillimin rajonal.

❖ Republika e Shqipërisë:

🌍 pozita gjeografike dhe roli i saj në integrimin rajonal dhe evropian;

🌍 ndryshimet në organizimin administrativo-territorial dhe ndikimi në zhvillimet rajonale.

integrim rajonal dhe evropian;

➤ përshkruan pozitën gjeografike dhe veçoritë kryesore natyrore të trevave të tjera shqiptare, rolin e tyre për zhvillimet rajonale;

➤ analizon tiparet kryesore të zhvillimit demografik dhe social-ekonomik të trevave të tjera shqiptare;

➤ analizon dallimet që ekzistojnë në zhvillimet rajonale midis pjesëve të ndryshme të trevave të tjera shqiptare, faktorët që kanë ndikuar dhe perspektivën e zhvillimit të tyre;

➤ vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Republikës së Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit rajonal e më gjerë, si urë lidhëse midis lindjes dhe perëndimit;

➤ përshkruan ndryshimet që kanë ndodhur në organizimin administrativo-territorial të vendit tonë;

➤ analizon organizimin e sotëm

administrativo-territorial të Republikës së Shqipërisë;

- argumenton ndikimin e organizimit të sotëm administrativ-territorial të Shqipërisë në zhvillimin dhe integrimin rajonal dhe evropian.

NËNTEMATIKA: TIPARET E PËRGJITHSHME NATYRORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

❖ Larmia e mjediseve dhe peizazheve natyrore të Shqipërisë.

Nxënësi:

- përshkruan larminë e mjediseve dhe të peizazheve natyrore të Shqipërisë dhe faktorët e përgjithshëm që kanë ndikuar në këtë drejtim;

❖ Larmia e formave të relievit dhe roli i relievit në ndryshimet rajonale.

- identifikon faktorët gjeografikë dhe interpretin rolin e tyre në krijimin e larmisë së formave të relievit;

❖ Klima, elementët kryesorë klimatikë dhe tiparet e tyre.

- interpretin me ndihmën e hartës, shtrirjen e elementëve kryesorë të relievit;
- analizon rolin e relievit në zhvillimet dhe shpërndarjen hapësinore të elementëve demografikë dhe ekonomikë;

Nxënësi:

- demonstron interes dhe kuriozitet për tiparet natyrore të vendit tonë;
- demonstron ndjeshmëri dhe kujdes për cilësinë e mjedisit natyror;
- është aktiv në shfrytëzimin e informacionit nga burime të ndryshme dhe e përdor atë efektivisht;
- vlerëson menaxhimin e qëndrueshëm dhe përdorimin eficient të burimeve natyrore;
- vlerëson marrjen e masave për të

<ul style="list-style-type: none"> ❖ Pasuritë klimatike dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve. ❖ Larmia dhe pasuria e madhe hidrografike. ❖ Roli dhe rëndësia e larmisë hidrografike për zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve të veçanta të tij. ❖ Larmia e tokave, vlerat, faktorët e degradimit dhe ndotjes së tyre. ❖ Larmia e madhe e florës dhe faunës së Shqipërisë, bazë e rëndësishme për zhvillimin e rajoneve të ndryshme. ❖ Trashëgimia natyrore e Shqipërisë – pasuri shumë e rëndësishme për zhvillime të caktuara rajonale. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>identifikon</u> elementët kryesorë klimatikë dhe tiparet e tyre; ➤ <u>evidenton</u> tiparet kryesore të klimës së vendit tonë dhe faktorët që ndikojnë në formimin e saj; ➤ <u>vlerëson</u> rolin dhe ndikimin e klimës në dukuritë e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe aktivitetet e saj; ➤ <u>analizon</u> larminë dhe pasurinë e madhe hidrografike të Shqipërisë dhe faktorët që kanë ndikuar; ➤ <u>vlerëson</u> rolin e pasurive hidrike për zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve të ndryshëm; ➤ <u>analizon</u> kushtet dhe faktorët që ndikojnë në larminë e tokave të vendit tonë; ➤ <u>analizon</u> faktorët dhe kushtet që kanë përcaktuar larminë dhe pasurinë e madhe bimore dhe shtazore të Shqipërisë; ➤ <u>vlerëson</u> rolin e pasurisë floristike dhe të faunës të vendit tonë për zhvillimin e rajoneve të ndryshme dhe rolin e 	<p>zvogëluar degradimin e habitateve natyrore në vendin tonë;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlerëson</u> dhe <u>respekton</u> pikëpamjet e të tjerëve; ➤ <u>paraqet</u> dhe <u>komunikon</u> lirshëm mendimet e tij; ➤ <u>respekton</u> përpjekjet personale dhe ato në grup.
--	---	--

❖ Raportet njeri-mjedis dhe ndikimi në gjendjen e peizazheve të ndryshme.

veprimtarisë njerëzore për ruajtjen dhe zhvillimin e biodiversitetit;

- evidenton disa ndër sitet e trashëgimisë natyrore të vendit tonë;
- hulumton në burime të ndryshme informacioni mbi zonat e mbrojtura të vendit tonë, pasurinë që ofrojnë dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e turizmit;
- identifikon faktorët kryesorë dhe pasojat e problemeve mjedisore në vendin tonë;
- interpretton faktorët që kanë ndikuar në shkallën e lartë të degradimit dhe shkretimit të tokave si dhe pasojat e tyre;
- vlerëson ndikimin e veprimtarisë njerëzore në ndryshimin e peizazheve të ndryshme;
- parashikon rrugë të menaxhimit efektiv të këtij ndikimi.

NËNTEMATIKA: POPULLSIA DHE EKONOMIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

- ❖ Popullsia dhe vendbanimet. Tiparet e zhvillimit të përgjithshëm demografik.
- ❖ Ecuria e numrit të përgjithshëm të popullsisë së Shqipërisë në periudha të ndryshme.
- ❖ Tiparet e shpërndarjes gjeografike të popullsisë.
- ❖ Lëvizja natyrore dhe ndikimet e saj në numrin e përgjithshëm të popullsisë.
- ❖ Migrimet e popullsisë dhe roli i vecantë i tyre në zhvillimet demografike të

Nxënësi:

- interpreton ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe vendbanimeve;
- analizon ecurinë e numrit të përgjithshëm të popullsisë së Shqipërisë përgjatë periudhave të ndryshme;
- dallon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen gjeografike të popullsisë;
- interpreton me ndihmën e hartës tiparet e shpërndarjes gjeografike të popullsisë;
- analizon tregues të lëvizjes natyrore të popullsisë;
- vlerëson ndikimin e lëvizjes natyrore të popullsisë në numrin e përgjithshëm të popullsisë;
- hulumton në burime të ndryshme informacioni dhe interpreton grafikë, të dhëna statistikore etj., në lidhje me ecurinë e numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe lëvizjen natyrore të saj;
- analizon procesin e migrimit si promotorin e të gjitha ndryshimeve demografike të

Nxënësi:

- vlerëson diversitetin shoqëror, kulturor dhe mjedisor;
- vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve;
- tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;
- komunikon lirshëm mendimet e tij;
- respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.

<p>vendit.</p> <p>❖ Tipare të strukturës cilësore të popullsisë së Shqipërisë (sipas moshës, gjinisë, vendbanimit, etnike, fetare etj).</p> <p>❖ Ekonomia e Shqipërisë dhe tipare të zhvillimit të saj në periudha të ndryshme.</p> <p>❖ Vlerësim i potencialeve natyrore dhe humane të vendit për zhvillimin e tij</p>	<p>popullsisë shqiptare, duke u ndalur në periudhën pas vitit 1990;</p> <p>➤ <u>evidenton</u> territoret ku kanë migruar shqiptarët me veçoritë dhe problemet e integritetit të tyre;</p> <p>➤ <u>evidenton</u> tiparet e përgjithshme të strukturës së popullsisë së Shqipërisë, referuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ moshës, ✓ gjinisë, ✓ vendbanimit; ✓ etnisë, ✓ fesë; <p>➤ <u>ndërton</u> dhe <u>analizon</u> grafikë të strukturës së popullsisë dhe hartat e shpërndarjes gjeografike të saj;</p> <p>➤ <u>përshkruan</u> tiparet e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, duke analizuar ecurinë e tyre përgjatë periudhave të ndryshme;</p> <p>➤ <u>vlerëson</u> potencialet natyrore dhe humane të Shqipërisë dhe ndikimin e tyre në</p>
---	--

<p>ekonomik.</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ Struktura e degëve dhe nëndegëve të ekonomisë. ❖ Mundësitë dhe problematikat e zhvillimit të ardhshëm ekonomik. 	<p>shkallën e zhvillimit ekonomik të vendit;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>analizon</u> rolin e sektorëve të veçantë të ekonomisë në zhvillimin e Shqipërisë (bujqësinë, industrinë, tregtinë, transportin, turizmin, shërbimet dhe artizanatin); ➤ <u>vlerëson</u> problemet aktuale dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, në kuadër të integritit rajonal dhe evropian; ➤ <u>ndërton</u> dhe <u>analizon</u> grafikët e strukturës së ekonomisë dhe degëve të saj si dhe hartat e shpërndarjes gjeografike të rajoneve kryesore bujqësore dhe industriale të trevave shqiptare. 	
---	--	--

NËNTEMATIKA: RAJONET GJEOGRAFIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

<ul style="list-style-type: none"> ❖ Rajonizimi gjeografik i Shqipërisë. Përcaktimi i rajoneve gjeografike dhe karakteristikat e përgjithshme të tyre. 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>identifikon</u> kriteret e rajonizimit gjeografik të Shqipërisë, ndarjen rajonale të saj dhe tipet e rajoneve; 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlerëson</u> diversitetin natyror, shoqëror dhe kulturor të rajoneve të Shqipërisë;
---	--	---

- ❖ **Rajoni Perëndimor:** pozita gjeografike, dhe pjesët përbërëse të rajonit.
 - ❖ Veçoritë kryesore natyrore të Rajonit Perëndimor dhe vlerësimi i tyre për zhvillimin e rajonit.
 - ❖ Karakteristikat kryesore të popullimit të Rajonit Perëndimor, me fokus të veçantë rritjen e shpejtë të popullsisë dhe ndryshimet strukturore të saj.
 - ❖ Lëvizjet e shumta të popullsisë drejt rajonit perëndimor, shkaqet dhe pasojat.
 - ❖ Veçoritë e urbanizimit të shpejtë të Rajonit Perëndimor dhe rrjedhojat e tij.
 - ❖ Tiparet e zhvillimit ekonomik të Rajonit Perëndimor dhe ecuria e këtij zhvillimi në periudha të ndryshme.
 - ❖ Struktura e degëve dhe nëndegëve të ekonomisë së rajonit. Roli i tyre në zhvillimin e përgjithshëm.
- vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Rajonit Perëndimor për zhvillimin ekonomik e social të tij dhe për zhvillimin e marrëdhënieve ndërrajonale brenda dhe jashtë Shqipërisë;
 - përshkruan veçoritë kryesore natyrore të Rajonit Perëndimor dhe potencialet natyrore për zhvillim;
 - evidenton karakteristikat kryesore të popullimit të këtij rajoni, me fokus të veçantë rritjen e shpejtë të popullsisë dhe ndryshimet strukturore të saj;
 - analizon shkaqet e lëvizjes së popullsisë drejt Rajonit Perëndimor dhe pasojat;
 - analizon urbanizimin e shpejtë të Rajonit Perëndimor dhe rrjedhojat e tij;
 - vlerëson zhvillimin bujqësor, industrial, të tregtisë, turizmit, transportit etj., të Rajonit Perëndimor;
 - hulumton në burime të ndryshme informacioni dhe interpretton grafikë, të dhëna statistikore, harta etj., në lidhje me
- vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve;
 - tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;
 - paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij;
 - demonstron pavarësi dhe objektivitet në kryerjen e detyrave;
 - respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.

- | | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> ❖ Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit Perëndimor. ❖ Mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit të mëtejshëm të rajonit. ❖ Rajoni Verior-Verilindor: veçoritë kryesore natyrore dhe potencialet e shumta natyrore për zhvillimin e tij. ❖ Pjesët përbërëse të Rajonit Verior - Verilindor dhe specifikat e tyre rajonale. ❖ Tiparet e zhvillimit demografik të Rajonit Verior - Verilindor (numri i popullsisë, shpërndarja e saj, struktura etj). ❖ Braktisja masive e Rajonit Verior - Verilindor pas vitit 1990, shkaqet dhe pasojat. | <p>ecurinë e zhvillimit ekonomik të Rajonit Perëndimor në periudha të ndryshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlerëson</u> trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Perëndimor dhe rolin e saj për zhvillimin e turizmit; ➤ <u>identifikon</u> mundësitë dhe <u>parashikon</u> perspektivën e zhvillimit të Rajonit Perëndimor; ➤ <u>përshkruan</u> mozaikun natyror të Rajonit Verior - Verilindor dhe potencialet natyrore për zhvillim; ➤ identifikon tiparet e përgjithshme natyrore të pjesëve përbërëse të Rajonit Verior - Verilindor ; ➤ <u>evidenton</u> tiparet kryesore të zhvillimit demografik të Rajonit Verior – Verilindor; ➤ <u>analizon</u> tendencën e ndryshimeve demografike të këtij rajoni me fokus të veçantë braktisjen pas viteve‘90; |
|---|---|

- ❖ Tipare të zhvillimit ekonomik të Rajonit Verior – Verilindor: midis potencialeve të shumta dhe vështirësive të mëdha.
 - ❖ Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit Verior - Verilindor.
 - ❖ Mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit të mëtejshëm të Rajonit Verior - Verilindor.
 - ❖ **Rajoni Juglindor:** pozicioni gjeografik dhe tiparet dalluese natyrore.
 - ❖ Pjesët përbërëse të rajonit dhe rëndësia ndërkufitare e tij për zvellimin rajonal.
 - ❖ Tiparet e zhvillimit demografik të
- analizon tiparet kryesore të aktivitetit aktual ekonomik të Rajonit Verior - Verilindor;
 - vlerëson trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Verior - Verilindor;
 - identifikon mundësitë dhe argumenton perspektivën e zhvillimit të Rajonit Verior - Verilindor, rolin e korridorit Durrës-Prishtinë në kuadër të këtij zhvillimi dhe të bashkëpunimit rajonal e më gjerë;
 - ndërton hartën e resurseve natyrore të Rajonit Verior – Verilindor, duke analizuar mundësitë e shfrytëzimit të tyre për zhvillimin social –ekonomik;
 - vlerëson pozitën gjeografike të Rajonit Juglindor për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal;
 - përshkruan tiparet dalluese natyrore të Rajonit Juglindor;
 - identifikon pjesët përbërëse të Rajonit Juglindor;
 - analizon tiparet dalluese dhe tendencën e

<p>Rajonit Juglindor.</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ Lëvizjet e fuqishme migratore të popullsisë së rajonit, veçanërisht pas vitit 1990 dhe efektet e tyre në zhvillimet rajonale. ❖ Potencialet dhe gjendja e zhvillimit ekonomik të Rajonit Juglindor në raport me rajonet e tjera. ❖ Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit Juglindor. ❖ Mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit të mëtejshëm të Rajonit Juglindor. ❖ Rajoni Jugor: tiparet e përgjithshme natyrore që dallojnë rajonin. 	<p>zhvillimit demografik të Rajonit Juglindor, me fokus të veçantë lëvizjet migratore pas viteve'90;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>evidenton</u> disa ndër pasojat e këtyre lëvizjeve në zhvillimet rajonale; ➤ <u>analizon</u> tiparet kryesore të veprimtarisë ekonomike të Rajonit Juglindor, duke e krahasuar dhe me rajonet e tjerë; ➤ <u>vlerëson</u> trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Juglindor dhe rëndësinë e saj për zhvillimin e turizmit; ➤ <u>identifikon</u> mundësitë dhe <u>argumenton</u> perspektivën e zhvillimit të Rajonit Juglindor; ➤ <u>ndërton</u> hartën e infrastrukturës rrugore të Rajonit Juglindor, duke evidentuar rolin e saj në integrimin dhe bashkëpunimin me shtetet fqinje dhe më gjerë; ➤ <u>vlerëson</u> rëndësinë e pozitës gjeografike ndërkufitare të Rajonit Jugor për zhvillimet rajonale; ➤ <u>përshkruan</u> tiparet e përgjithshme natyrore
---	--

- | | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> ❖ Tiparet e zhvillimit demografik të Rajonit Jugor (numri i popullsisë, shpërndarja e saj, struktura etj). ❖ Migrimet e popullsisë dhe pasojat e tyre në zhvillimet rajonale. ❖ Struktura e zhvillimit ekonomik të Rajonit Jugor dhe pasojat ndërrajonale të saj. ❖ Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit Jugor. ❖ Mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit të mëtejshëm të Rajonit Jugor. | <p>që dallojnë Rajonin Jugor;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>analizon</u> tiparet dalluese të zhvillimit demografik të Rajonit Jugor; ➤ <u>evidenton</u> pasojat e migrimeve të popullsisë së Rajonit Jugor; ➤ <u>dallon</u> tiparet kryesore të veprimtarisë ekonomike të Rajonit Jugor dhe pasojat ndërrajonale të saj; ➤ <u>vlerëson</u> trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Jugor dhe rëndësinë e saj; ➤ <u>identifikon</u> mundësitë dhe argumenton perspektivën e zhvillimit të Rajonit Jugor; ➤ <u>ndërton</u> hartën e zonave kryesore turistike të Rajonit Jugor. |
|--|--|

4. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies, në lëndën e gjeografisë, janë faktorë të rëndësishëm për një mësimdhënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.

Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënit të tyre.

Mësimdhënia dhe të nxënit, bazuar në kompetenca, kërkon që në përzgjedhjen dhe përdorimin e strategjive, teknikave dhe metodave të mësimdhënies, mësuesit e kësaj lënde:

- të marrin parasysh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësit, që nënkupton përvojat individuale të tij dhe, mbi këtë bazë, të mbështesin e orientojnë të nxënit e tij;
- të nxitin vrojtimin e drejtpërdrejtë, kureshtjen, arsyetimin dhe gjykimin nëpërmjet demonstrimeve dhe vëzhgimeve në natyrë;
- të nxitin të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
- të motivojnë nxënësin, duke e konsideruar si partner, në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit;
- të mbështesin të nxënit e pavarur dhe në bashkëpunim të nxënësve përmes punës me projekte, punës në grup, punës individuale;
- të mbajnë parasysh integrimin dhe marrëdhënien ndërmjet lëndëve të fushës” Shoqëria dhe mjedisi”, zbatimet e tyre në jetën e përditshme, si dhe lidhjen ndërlëndore;
- të shfrytëzojnë burime të shumëllojshme informacioni dhe ta çmojnë tekstin si një burim të rëndësishëm, por të pamjaftueshëm për përmbushjen e kompetencave të fushës;
- të përdorin TIK-un si mbështetës dhe lehtësues të mësimdhënies dhe të nxënit.

Rolet që ndërmarrin nxënësi dhe mësuesi në realizimin e kësaj qasje janë:

- ❖ *Nxënësi – veprues dhe i interesuar.* Në gjeografi, nxënësi studion dukuritë dhe proceset gjeografike. Ai nxitet të kërkojë përgjigje për pyetjet që ngre, duke hulumtuar në burime të ndryshme dhe, duke përdorur teknika specifike të gjeografisë. Nxënësi angazhohet të vendosë lidhje ndërmjet asaj që di dhe asaj që zbulon dhe mbi këtë bazë ndërton dijen e tij, bashkëvepron me shokët/shoqet dhe mësuesin, ndan me ta vëzhgimet dhe përvojat e tij. Ai punon individualisht, ose në grup dhe mbështetet nga mësuesi.
- ❖ *Nxënësi si partner.* Partneriteti i mësuesit me nxënësin në mësimdhënie rrit motivimin dhe e bën mësimdhënien më tërheqëse, duke krijuar kushte që ajo të jetë e suksesshme;
- ❖ *Mësuesi - udhëheqës dhe lehtësues.* Mësuesi i gjeografisë ndihmon nxënësit të zbulojnë kënaqësitë e të nxëniet. Roli i mësuesit konsiston në udhëheqjen e nxënësve; ai moderon nxënësit në eksplorimin e dukurive gjeografike. Mësuesi vepron si moderator midis dijes dhe nxënësit, duke e ndihmuar nxënësin të përfshihet në procesin e ndërtimit të dijes. Ai krijon kontekste të nxëni, të cilat i aftësojnë nxënësit të përftojnë mjetet e gjeografit. Zbatimi i programit kërkon që mësuesi të përdorë strategji mësimdhënieje duke respektuar stilet e të nxëniet të nxënësve. Ai i angazhon nxënësit në ndërtimin e mendimit, duke nxitur diskutimet dhe ballafaqimin e këndvështrimeve të ndryshme.

Mësimdhënia dhe të nxëniet në gjeografi duhet të mbështeten në situata të jetës reale. Të nxëniet fillon kur ata përpiqen të zgjidhin probleme dhe të eksplorojnë situata të jetës reale për të gjetur përgjigjet e pyetjeve që kanë, ose për të zgjidhur probleme. Të nxëniet me situata përfshin pjesëmarrjen e nxënësve në detyra që janë të ngjashme me zbatimet në botën reale. Kërkimi, analiza dhe përzgjedhja e të dhënave duhet të jenë gjithmonë pjesë e situatave të të nxëniet. Ato duhet të mbështeten në kërkimin gjeografik, i cili përfshin analizën krahasuese të dukurive gjeografike në shkallë të ndryshme. Këto lloj situatash kërkojnë zhvillimin e shprehive të të pyeturit, analizës, mendimit kritik dhe krijues.

Programi i gjeografisë në klasën X dhe XI u krijon nxënësve hapësirë dhe mundësi situatash të nxëni përmes punës dhe vëzhgimeve në terren, diskutimit të çështjeve aktuale në nivel lokal dhe global, të tilla si: ndryshimet klimatike, tërmetet, katastrofat natyrore, përmbytjet, rrëshqitjet e dherave, erozioni i lumenjve, i plazheve etj.; analizave të zhvillimeve demografike dhe ekonomike të vendit dhe rajoneve përbërës etj.

Nxënësit me nevoja të veçanta

Organizimi i kurrikulës sipas kompetencave, në fusha të nxëni, në shkallë dhe me fokus integrimin, u krijon mësuesve hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënit e tyre. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motivim, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj.. Në disa raste duhen bërë përshtatje të kurrikulës sipas diferencave të zhvillimit brenda një grupi moshor. Mësuesit mund të zgjerojnë zhvillimin e kompetencave kyçe si ato të komunikimit, të menduarit dhe shoqërore sipas nevojave individuale të nxënësve, për të zvogëluar dhe zhdukur diferencat brenda një shkalle të kurrikulës, në fund të saj.

Nxënësit me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënit njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të kompetencës, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta.

Në rastin e nxënësve ,që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

Nxënësit e talentuar

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar.

Mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijojnë mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe të zgjeruar, të zhvillojnë në mënyrë të vazhdueshme elemente specifike të kompetencave kyçe (p.sh: aftësitë e nivelit të lartë konjitiv të kompetencës së të menduarit) dhe specifike të fushës, të fokusohen në çështjet kroskurrikulare, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënësve brenda dhe jashtë shkollës.

5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve. Vlerësimi mat shkallën në të cilën janë arritur (nga nxënësit) njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e dëshiruara. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënësve në nivel klase dhe shkalle. Me këtë informacion, mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësve, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit nga nxënësi të kompetencave të fushës “Shoqëria dhe mjedisi”. Vlerësimi u shërben mësuesve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, nxënësve për të përmirësuar të nxënësve si dhe prindërve për të monitoruar progresin e fëmijëve të tyre në shkollë.

Mësuesit duhet të përdorin situata të jetës reale si pikënisje për vlerësimin e nxënësve. Format e ndryshme të vlerësimit duhet t'u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to.

Për vlerësimin e nxënësve, mësuesit duhet të mbështeten në disa parime bazë:

- ❖ Vlerësimi duhet të jetë i ndershëm dhe i paanshëm. Nxënësit duhet t'i jepet mundësia të demonstrojnë shkallën e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve.
- ❖ Vlerësimi duhet t'i ndihmojë nxënësit. Ai duhet t'u japë informacion pozitiv dhe nxitës për t'u përfshirë aktivisht në procesin e të nxënësve.

- ❖ Vlerësimi udhëhiqet nga rezultatet e të nxënit dhe shfrytëzon shumëllojshmëri strategjishë dhe teknikash vlerësimi.

Disa ndër to mund të jenë:

- ❖ Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj;).
- ❖ Vlerësimi përmes punëve praktike.
- ❖ Vlerësimi përmes projekteve kurrikularë, lëndorë ose ndër lëndorë.
- ❖ Vlerësimi me shkrim (detyra të veçanta për grupe nxënësish, testime, detyra në grup ose individualisht).

Mësuesi vlerëson nxënësin edhe përmes përdorimit të portofolit. Ai është një koleksion sistematik i punës së nxënësve dhe siguron një tablo të plotë të arritjes së tyre. Punët e mbledhura ofrojnë të dhëna të shumta për zhvillimin dhe progresin e nxënësve në përvetësimin e njohurive, të kuptuarit e koncepteve, zbatimin e shkathtësive dhe zhvillimin e qëndrimeve. Ai gjithashtu u afron nxënësve mundësi për vetëvlerësim dhe reflektim përmes rishikimit të portofoleve të tyre.

6. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënit në fushën “Shoqëria dhe mjedisi” ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj;

Ndërsa mësuesi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues. Ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë akses në burimet e ndryshme të të nxënës. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në gjeografi është e larmishme: muzeume, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizive, etj.. Gjithashtu burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

Sugjerime për përdorimin e TIK-ut

- ❖ Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- ❖ Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet Web për gjeografinë.
- ❖ Përdorimi i CD-ROM për mbledhjen e informacionit mbi temat që nxënësi studion.
- ❖ Organizimi dhe prezantimi i të dhënave, duke përdorur tipa të ndryshëm software.
- ❖ Përdorimi i simulimeve software.
- ❖ Përdorimi i grafikëve software.
- ❖ Paraqitja grafike e të dhënave.